Kronikë

Qarkullonin të armatosur dhe me drogë në rrugët e Fierit, në pranga 2 shokët! Njëri me dy identitete, dyshohen si shpërndarës (Emrat)

Po lëviznin me makinë në aksin Dërmenas-Pojan, agjentët u gjetën një pistoletë, 170 fishekë dhe lëndën narkotike. Po verifikohet aktiviteti kriminal

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
16 Gusht, 11:44 | **Përditesimi: 16 Gusht, 11:50**

Share

Fier- Qarkullonin në rrugët e Fierit të armatosur dhe me lëndë narkotike, arrestohen 2 shokët e dyshuar, njëri prej të cilëve mbante edhe dy identitete.

Ata dyshohet se i përkasin një grupi të shpërndarjes së drogës në qark, por po verifikohet edhe për precedentë të tjerë kriminalë.

Policia vendore njoftoi sot (16 Gusht) se ka finalizuar operacionin e koduar "Sundimi i ligjit", pas sinjalizimeve se dy të rinj posedonin armatime dhe drogë dhe udhëtonin në aksin Pojan-Dërmenas.

[Sh.com]

LEXO EDHE:
Ndezën zjarre në Mallakastër e Bulqizë, digjen pemë dhe ullishte! Procedohen 2 piromanë

Kanë qenë agjentët e Antidrogës dhe Patrullat, që bënë ndjekjen dhe prangosjen e tyre. Të ndaluarit janë Patrik Ferko, që mbante edhe identitetin Pëllumb Xhafa, 49 vjeç dhe Ersi Hoxhaj, 20 vjeç, të dy banues në fshatin Dërmenas.

Gjatë ndërhyrjes u sekuestruan arma e zjarrit pistoletë, 170 fishekë të kalibrave të ndryshëm, dhjetëra doza cannabis sativa, 2 celularë dhe automjeti.

Ndaj të rinjve u ngritën akuzat "prodhimi dhe shitja e narkotikëve" dhe "mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", të kryera në bashkëpunim, kurse dosja i kaloi prokurorisë vendore.

A.Q/r.k./Shqiptarja.com

TAG: dermenas Arrestime droge Fier

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës:
Ftesa e Ramës, a duhet të kthehen emigrantët që punojnë në turizëm?

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

Fier/ I premtojnë se do e çojnë në Mal të Zi, 2 fierakë fusin në makinë emigrantin pakistanez, e dhunojnë i marrin paratë dhe e lënë në mes të rrugës
17 Gusht, 10:14

Itali/ I kthenin shtëpitë me qira në baza droge dhe monitoronin Policinë me kamera, arrestohen 2 shqiptarët! U gjenden armë, municione, kokainë dhe hashash
17 Gusht, 08:13

Zjarr në Çërrilë të Mallakastrës, digjet 1 shtëpi e mbi 1000 rrënjë ullinj! Ndërhyhet nga ajri për shuarjen e flakëve
16 Gusht, 18:28

Aksident në Levan-Vlorë, përplasen dy automjete! Dy persona dërgohen në spital

Kristaq Thano

16 Gusht, 18:06

Vendosen barrierat metalike në rrugën Zhymë-Krutje në Lushnjë, Braçe: S'do të jetë më 'kthesa e vdekjes'
16 Gusht, 18:00

Kishte humbur kontaktet me familjen, Palombarët e RENEA-s gjejnë të mbytur në kanal 21-vjeçarin në Lushnjë
16 Gusht, 15:33

Mjekë dhe tregtarë droge, arrestime masive për vdekjen e Matthew Perry-t
15 Gusht, 18:25

Donin të rigjeneronin kullotat për sezonin e ri, por djegin 3 ha tokë në dy fshatra! Procedohen i moshuari dhe 40-vjeçari në Burrel
15 Gusht, 14:53

Shkrumboi 50 hektarë me pemë frutore dhe ullinj teksa po digjte mbeturinat, arrestohet piromani 70-vjeçar në Lushnjë! U rrezikuan edhe banesat
15 Gusht, 14:03

Tiranë/ Dhunohet infermieri në krye të detyrës te "Nënë Tereza", arrestohet 23-vjeçari
15 Gusht, 10:07

Mbante 21 gramë drogë me vete, shqiptari për t'i shpëtuar arrestimit bën për spital 2 policët italianë gjatë aksionit
15 Gusht, 07:25

Shisnin kokainë dhe hashash në lokalet e natës në Himarë, arrestohen 2 shokët nga Tirana
14 Gusht, 15:01

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje